



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE

Zyra e Kryeprokurorit

AD.nr.2/2024

Më datë: 10 Shtator 2024

Gjilan

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan si autoritet kompetent, merr këtë:

V E N D I M

HUDHET, ankesa e paraqitur nga [REDACTED] me nr.ref. [REDACTED] për shkelje disiplinore nga prokurori [REDACTED]

A r s y e t i m i

Më datë 13 Gusht 2024, përmes e-mailit nga [REDACTED] kemi pranuar ankesën me nr. ref. [REDACTED] për shkelje disiplinore nga prokurori [REDACTED] gjatë trajtimit dhe vendosjes në lëndën PPN.I.nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në Spitalin Regjional të Gjilanit, sipas pretendimeve të paraqitura nga [REDACTED].

Më datë 20 Gusht 2024, konform nenit 9 par. 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, për pranimin e ankesës nga [REDACTED].

[REDACTED] në ankesë pretendon se më datë 11 Gusht 2023, ka dorëzuar një kërkesë për iniciimin e hetimeve në lidhje me konkursin e punësimit të kundërligjshëm [REDACTED] në [REDACTED] në Gjilan, ku personat përgjegjës përmes ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave të tyre zyrtare kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nenin 414 të KPRK-së. Më tutje në ankesë është pretenduar se pas zhvillimit të procedurës

hetimore, prokurori më datë 23 Tetor 2023, me raportin PPN.I.nr. [REDACTED] ka mbyllur rastin padrejtësisht dhe kundërligjshëm pa vlerësuar drejt gjendjen reale dhe faktike, e cila ka qenë e mbështetur në prova konkrete, të cilat dëshmojnë se provat e prezantuar kanë dëshmuar qartë se [REDACTED] me rastin e aplikimit për pozitën e hapur nga [REDACTED] Gjilanit, sipas konkursit publik nr. [REDACTED] të datës 17 Gusht 2021, nuk ka qenë e pajisur me licencë adekuate, si njëri prej kriterëve kryesore në këtë konkurs. Me rastin e mbylljes së rastit prokurori [REDACTED] ka përdorur Ligjin nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili ka hyrë në fuqi më datë 22 Shtator 2023, ndërsa shkëljet e pretenduara kishin ndodhur para kësaj date, ku në vend të këtij ligji, është dashur ta përdor Ligjin Nr.06/L-114, i cili ka qenë fuqi gjatë periudhës së aplikimeve dhe konkurrimit. Sipas ankuesit për të vërtetuar gjetjet e tyre, nga [REDACTED] kanë kërkuar të trajtojnë këtë rast, ku nga Drejtori i Përgjithshëm [REDACTED] kanë marrë përgjigje se me vendimin nr.prot. [REDACTED] të datës 23 Gusht 2024, ka formuar një komision për të vërtetuar pretendimet e ngritura nga [REDACTED], ku komisioni më datë 14 Mars 2024, ka nxjerr një raport, sipas të cilit është konstatuar se kandidatja [REDACTED], për pozitën [REDACTED] në [REDACTED] në Gjilan, nuk i ka përmbushur disa kriteret e konkursit, veçanërisht atë të shtetësisë dhe posedimin e licencës në kohë të aplikimit.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës të paraqitur nga ana e [REDACTED], me qëllim të verifikimit të këtij dyshimi, kemi kërkuar shkresat e lëndës PPN.I. [REDACTED] dhe pas vlerësimit të cilave kemi konstatuar këtë gjendje:

Prokuroria Themelore në Gjilan / Departamenti për Krime të Rënda, më datë 16 Gusht 2023, nga Policia e Kosovës – DHKEK/NJRKEK në Gjilan, ka pranuar shënimin zyrtar më numër të rastit [REDACTED], lidhur me rastin e paraqitur nga [REDACTED] për shkak të dyshimit për punësimin e një [REDACTED] në mënyrë të kundërligjshme në [REDACTED] në Gjilan.

Më datë 08 Shtator 2023, Prokuroria Themelore në Gjilan / Departamenti për Krime të Rënda, ka autorizuar Policinë e Kosovës – NJHRKEK, që të ndër marr veprime hetimore në drejtim të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së.

Më datë 10 Tetor 2023, Policia e Kosovës – NJHRKEK në Gjilan, ka dorëzuar raportin informues lidhur me veprimet hetimore të cilat i ka ndërmarr :

-Sa i përket dyshimit se [REDACTED] [REDACTED], është punësuar në [REDACTED] në Gjilan, pa qenë shtetase e Republikës së Kosovës, ku një ndër kriteret e përgjithshme për pranimit në detyrë zyrtare sipas nenit 9 pika 1 nën pika 1.1 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik, është përcaktuar "të jetë shtetasi Republikës së Kosovës", e që nuk është kontestuese se e njëjta nuk ka qenë shtetase e Republikës së Kosovës, mirëpo nga shkresat e lëndës është konstatuar se e njëjta

ka poseduar leje qëndrimi në RKS-së, lëshuar nga MPB të Kosovës, me nr. IF [REDACTED] njëjta për çdo vit e ka përsëritur lejen e qëndrimit deri në vitin 2024 në territorin e Kosovës, e po ashtu nëse i referohemi pikës 3 të nenit 9 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik, "Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.1. dhe 1.3. të këtij neni, të huajt, pjesëtarët/ët e diasporës dhe shtetasit/it nga vendet me të cilat Republika e Kosovës ka marrëveshje, të cilat/ët posedojnë kualifikimet e nevojshme për vendin e punës, mund të pranohen si zyrtarë publik. Qeveria, me akt nënligjor përcakton funksionet shtetërore në të cilat këto kategori mund të pranohen si zyrtarë publik", gjë që vërteton se e njëjta e ka plotësuar këtë kriter.

- Sa i përket pretendimeve se kinse kandidatja [REDACTED] në kohën e aplikimit nuk ka qenë e licencuar me licencë të punës, nga shkresat e lëndës është konstatuar se Ministria e Shëndetësisë në Prishtinë, bazë të nenin 5.9 të Udhëzimit Administrativ 04/2006, mbi Edukimin Themelor Profesional dhe Provimi i Licencës për punëtorët shëndetësorë, Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar certifikatë me numër PL-In-[REDACTED] të datës 13 Shtator 2021, për kandidaten [REDACTED] Baçelor i [REDACTED] me të cilën është vërtetuar se e njëjta e ka dhënë provimin e licencës më datë [REDACTED], ku kjo certifikatë është e firmosur dhe vulosur nga Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës, që do të thotë se në kohën e aplikimit për konkurs kandidatja ka qenë e licencuar, ndërsa sa i përket ankuesit se e njëjta ka dorëzuar dokumentin e licencës së punës pas afatit, me 04 Tetor 2021, ky ka qenë vetëm një akt formal juridik-procedural, nga se Certifikata e lëshuar më datë [REDACTED] vërteton se e njëjta në kohën e aplikimit ka pasur të dhënë provimin e licencës, ngase konkursi është hapur më datë 17 Shtator 2021, ndërsa aplikuesit kanë mundur të konkurojnë deri më datë 24 Shtator 2021.

-Në bazë të kërkesës së datës 29 Shtator 2023, të Policisë së Kosovës – NJHKEK në Gjilan, më datë 02 tetor 2023, Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës, ka dhënë përgjigje me shkrim me nr. pro [REDACTED] ku ndër të tjera në pikën 3 të kësaj përgjigjeje ka cituar :Ministria e Shëndetësisë si autoritet liqencues deri në themelimin e Odës ka nxjerrë vendim me të cilin të gjithë profesionistët shëndetësor me prejardhje nga Lugina e Preshevës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut të cilët kanë kryer shkollimin e rregullt në Kosovë ju lejohet ushtrimi i veprimtarisë profesionale në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private.

-Në bazë të dokumenteve të verifikuara në dosjen e [REDACTED] është konstatuar se e njëjta ka diplomuar në Fakultetin e [REDACTED] të Universitetin të Prishtinës dhe ka marrë titullin bachelor i [REDACTED] në studimet e kryera nga viti akademik 2009-2010 deri në vitin 2012. Nga viti 2008/2009 deri në vitin 2012, ka fituar titullin [REDACTED] Diplomuar bachelor në Fakultetin [REDACTED] të Universitetit të Prishtinës dhe në vitin 2018 ka fituar titullin LL.M. Master në të drejtën [REDACTED] në Fakultetin [REDACTED] në Universitetin e Prishtinës dhe nga viti akademik 2013/2014 deri në vitin 2019 ka mbaruar studimet në universitetin e Prishtinës [REDACTED] duke fituar titullin Master i [REDACTED].

Po ashtu Policia e Kosovës NJHRKEK në Gjilan, më datë 27 Shtator 2023, në cilësi të dëshmitares ka intervistuar [REDAKTUAR] – UD e [REDAKTUAR] e cila ndër të tjera ka deklaruar se në kriteret e konkursit kanë qenë të ketë të kryer fakultetin e infermierisë së përgjithshme – bachelor, licencën e punës me afat, letërnjoftimin kopje, certifikatën e lindjes certifikatën e lëshuar nga gjykata etj, e që kandidatja [REDAKTUAR] i ka poseduar, pasi që ne jemi bazuar në leje qëndrimin e saj, ku ceket për punësim (employment) si dhe licencën ku potencohet se të drejtë të punoj në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e që këtë dy dokumente paraprakisht kanë kaluar në dy instanca më të larta siç është Ministria e Shëndetësisë kur e ka lëshuar licencën pastaj Oda e [REDAKTUAR] që e ka aprovuar këtë licencë me të drejtë punësimi në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe leje Qëndrimi i lëshuar nga Ministria e Punëve të brendshme. Sa i përket asaj se e njëjta nuk e ka poseduar licencën e punës, kjo nuk qëndron se e njëjta ka poseduar certifikatën e cila ka dëshmuar se e ka fituar licencën por ishte në pritje të procedurave administrative, ku edhe ne si institucion nuk kemi pasur të drejtë t'ia mohojmë të drejtën për punësim.

Bazuar në provat e siguruara, pas vlerësimit të tyre si tërësi, prokurori i rastit ka nxjerrë raport për mbylljen, të cilin e ka arsyetuar bazuar në provat e siguruara të cilat nuk kanë dhënë bazë për fillimin e një hetimit formal, e as për ndërmarrjen e ndonjë veprimi shtesë, dhe në këtë kontest konsiderojmë se ka vepruar në pajtim me autorizimet e tija ligjore. Duke iu referuar dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurorin e Shtetit: **Neni 3 Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit është kriter themelore për ushtrimin e autorizimit të prokurorit, pas që sipas par. 1 dhe 2 të kësaj dispozite "Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme; Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykitime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore, apo pozitës shoqërore; Është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën për cilindo person fizik apo juridik që të ndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë te Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale.**

Po ashtu sipas Neni 47 të Kodit të Procedurës Penale "Gjatë hetimit të veprave penale, prokurori i shtetit detyrohet të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe të sigurojë që provat të mbliidhen në përputhje me këtë Kod", sipas të cilës dispozitë edhe ka vepruar prokurori, prandaj edhe konstatohet se në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore e paraparë nga neni 6 parag. 1 e 2 të Ligjit numër 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore dhe arsyet faktike të cilat u cekën më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KRYEPROKURORI

Kopje/njoftim konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve:

1x1 kopje z. [REDACTED], [REDACTED] të Kosovës;
1x1 kopje, [REDACTED], [REDACTED] rruga "[REDACTED]" p.n
1x1 kopje, arkivës.